



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBËTËAR



Tiranë më, 08.11.2022

V E N D I M

Nr.24, datë 08.11.2022

Në mbështetje të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 16.2.ç.), të këtij ligji, Këshilli Kombëtar,

V E N D O S I:

1. Të miratojë me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje, propozimet e zyrës juridike për kategorinë e psikologëve që kanë përfituar një Licencë dhe kërkojnë të pajisen me një të dytë.
2. Bashkëngjitur Vendimit të Këshillit Kombëtar gjeni relacionin e zyrës juridike.

PRESIDENTE E URDHRI

Valbona TRESKA



SEKRETARE

Armira BABOÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
ZYRA JURIDIKE



Procedura për licencimin e psikologëve, të cilët e kanë përfituar më parë një licencë lëshuar Urdhri i Psikologut, me një titull të dytë (apo edhe më shumë) leje të ushtrimit të profesionit

Urdhri i Psikologut ka marrë disa kërkesa nga psikologë, të cilët janë të pajisur më parë me një Leje Individuale të Ushtrimit të Profesionit (Licencë Profesionale) dhe pasi kanë përfunduar një tjetër cikël studimi Master (të ndryshëm nga i pari), kërkojnë të përfitojnë edhe titullin e dytë të lejes së ushtrimit të profesionit.

Sqarojmë fillimisht se çdo profesionist, i cili ka përfunduar dy cikle të studimit (Bachelor+Master) apo ciklin 4 vjeçar në fushën e psikologjisë, bazuar në Ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe bazuar në Ligjin Nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", duhet të kryejë Praktikën Profesionale si dhe Provimin e Shtetit, në mënyrë që më pas të mund të pajiset me licencë.

Praktika Profesionale për psikologët nisi zyrtarisht pas nënshkrimit të Urdhrit të përbashkët "Për miratimin e Rregullores së Praktikës Profesionale për profesionin e rregulluar të psikologut në Republikën e Shqipërisë", ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në datë 30.01.2018.

Duke qenë se profesioni i psikologut u rregullua me ligj vetëm në vitin 2016, por ndërkohë që është ushtruar si profesion vite më parë, Urdhri i Psikologut në bashkëpunim me autoritetin e tij kompetent Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për t'i ardhur në ndihmë kësaj kategorie të profesionistëve psikologë me eksperiencë në ushtrimin e psikologut, në procesin e përfitimit të licencës, nënshkroi në datë 17.05.2018 një Memorandum Bashkëpunimi.

Bazuar në këtë Memorandum Bashkëpunimi e më konkretisht në nenin 5 të tij, do të përjashtohen plotësisht nga kryerja e Praktikës Profesionale psikologët të cilët:

Kanë ushtruar në mënyrë të rregullt profesionin si psikolog, për të paktën 1 vit para hyrjes në fuqi të Rregullores së Praktikës Profesionale.

Nisur nga sa më sipër, përjashtohen nga kryerja e Praktikës Profesionale të gjithë ata psikologë, të cilët kanë ushtruar, të paktën për 1 vit, në mënyrë të rregullt profesionin e psikologut, përpara hyrjes në fuqi të Rregullores së Praktikës Profesionale (30.01.2018). Për saktësim periudha e vlerësimit, për përjashtimin nga Praktika Profesionale është që nga momenti i hyrjes në fuqi të



Ligjit Nr.40/2016 “Për Urdhrit e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, pra nga data 24.05.2016, e deri në momentin e nënshkrimit të Urdhrit për miratimin e Rregullores së Praktikës profesionale, në datë 30.01.2018.

Duke mbajtur në konsideratë ligjet, aktet nënligjore, marrëveshjet e Urdhrit të Psikologut me institucionet përkatëse me të cilat insitucioni ynë funksionon, praktikën aktuale të ndjekur nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, lidhur me kategorizimin e zhvillimit të Provimit të Shtetit bazuar në Fushat e Kompetencës, duke mbajtur në vëmendje gjithashtu problematikën e ushtrimit të profesionit brenda kufijve të kompetencës (standardi 2.02. i Kodit Etik) dhe për të vlerësuar me shumë kujdes kërkesën e kategorisë së psikologëve, të cilët kanë përfituruar një licencë, në sajë të eksperiencës në ushtrimin e profesionit të psikologut dhe që pas përfundimit të një cikli tjetër studimi në fushën e psikologjisë, kërkojnë të përfitojnë edhe një licencë tjetër me titullin e ri, duhet të ndjekin procedurën si më poshtë:

- 1) Kategoria e psikologëve të cilët kanë përfituruar më parë Lejen Individuale të Ushtrimit të Profesionit (Licencën Profesionale) dhe që pas përfundimit të një cikli tjetër studimi Master në fushën e psikologjisë, kërkojnë të përfitojnë Lejen e Ushtrimit të Profesionit edhe me titullin e ri, por që nuk vërtetojnë eksperiencën në ushtrimin e profesionit në atë fushë kompetence, për të cilën kërkojnë të licencohen, për të paktën 1 vit, sipas parashikimeve të nenit 5 të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet që:
 - Të depozitojnë një kërkesë bashkëngjitur me fotokopjen e njehsuar me origjinalin të diplomës së studimeve të kryera nga universiteti përkatës.
 - Të zhvillojnë Praktikën Profesionale 1 vjeçare në fushë e kompetencës, sipas profilit të studimeve të kryera, për të cilin kërkojnë të përfitojnë licencën.
 - Pas përfundimit me sukses të Praktikës Profesionale t’i nënshtrohen Provimit të Shtetit, për fushën e kompetencës, për të cilën kërkojnë të përfitojnë licencë, bazuar në profilin e studimeve të kryera.

- 2) Kategoria e psikologëve të cilët kanë përfituruar më parë Lejen Individuale të Ushtrimit të Profesionit (Licencën Profesionale) dhe që pas përfundimit të një cikli tjetër studimi Master në fushën e psikologjisë, kërkojnë të përfitojnë Lejen e Ushtrimit të Profesionit edhe me titullin e ri dhe që vërtetojnë eksperiencën në ushtrimin e profesionit në atë fushë kompetence, për të cilën kërkojnë të licencohen, për të paktën 1 vit sipas parashikimeve të nenit 5 të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për përjashtimin nga kryerja e Praktikës Profesionale duhet që:
 - Të depozitojnë një kërkesë bashkëngjitur me fotokopjen e njehsuar me origjinalin të diplomës së studimeve të kryera nga universiteti përkatës.
 - Të depozitojnë vërtetimin e punës, që provon eksperiencën në atë fushë, për të cilën psikologu ka shprehur interesin për pajisjen me licencë.
 - Bazuar në eksperiencën në fushën e kompetencës, këto kërkesa do të jenë objekt i shqyrtimit nga Komisioni i Praktikës, i cili do të vlerësojë nëse plotësohen kriteret për përjashtimin e plotë apo jo, nga kryerja e Praktikës profesionale, bazuar në nenin 5 të



Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për përjashtimin nga Praktika profesionale.

- Në rast të një vendimmarrje për përjashtimin e plotë nga kryerja e Praktikës Profesionale, kjo kategori psikologësh t'i nënshtrohet Provimit të Shtetit, për fushën e kompetencës, për të cilën kërkojnë të përfitojnë licencë, bazuar në profilin e studimeve të kryer.
- 3) Psikologët, të cilët do të përfitojnë Lejen Individuale të Ushtrimit të Profesionit (Licencë Profesionale) për herë të dytë apo edhe më shumë se dy herë, të pajisen me një dokument të ri, të ndryshëm nga dokumenti i parë (Licenca e parë), pra titulli i ri për ushtrimin e profesionit të mos shtohet titullit të licencës që disponojnë, kjo për shkak se:
- Janë dy apo më shumë Licenca që i përkasin profileve të ndyshme të fushës së psikologjisë, në të shumtën e rasteve edhe fushave të ndryshme të kompetencës.
 - Bazuar në Ligjin Nr.40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", këto licenca kanë vlefshmëri 5 vjeçare. Çdo licencë ka një datë të fillimit të vlefshmërisë, ndaj duke patur data të ndryshme të vlefshmërisë, këto tituj nuk mund të bëhen pjesë e të njëjtit dokument, pra e së njëjtës licencë.
 - Secila Leje e ushtrimit Individual të Profesionit ka periudhën e saj të vlefshmërisë sa i përket përlogaritjes për përfitimin e krediteve të nevojshme për rilicencim, bazuar në Rregulloren e Edukimit në Vazhdim.
- 4) Psikologët, të cilët në të ardhmen do të përfitojnë dy apo më shumë Licenca për ushtrimin e profesionit të psikologut dhe që dëshirojnë të vënë në funksion (përdorim) për ushtrimin e profesionit vetëm në njërën prej tyre, duhet të:
- Bëjnë një kërkesë zyrtare, apo të firmosin një deklaratë pranë Urdhrit të Psikologut, ku të shprehin vullnetin në lidhje me faktin nëse do t'i posedojnë ose jo këto licenca dhe nëse do ta ushtrojnë profesionin në të dyja (apo edhe më shumë) fushat e kompetencës, të fituara nga dhënia e licencës.
 - Në momentin që psikologu do të heqë dorë nga njëra prej licencave, ky psikolog të mos shlyejë detyrimet, që burojnë nga posedimi i asaj licence, siç janë kryerja e pagesës për rinovimin e licencës apo edhe përfitimi i krediteve të vlefshme për rilicencim, bazuar në Rregulloren e Edukimit në Vazhdim.
 - Në momentin e përfundimit të vlefshmërisë së licencës, për të cilën psikologu na ka komunikuar se nuk do ta vërë në funksion për ushtrimin e profesionit, atëherë kjo licencë automatikisht nuk do të rinovohet për periudhën e ardhshme 5 vjeçare.
 - Nëse në të ardhmen pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së kësaj licence, psikologu do të kërkojë rifitimin e të drejtës për marjen e asaj licence, atëherë duhet t'i nënshtrohet Provimit që zhvillohet pranë Urdhrit të Psikologut.
 - Nëse psikologu i cili ka pezulluar anëtarësinë nga Urdhri i Psikologut, apo ka shprehur vullnetin për mos të ushtrouar profesionin në ndonjërin prej titujve të



licencës të përfituara dhe që në të ardhmen (brenda afatit të vlefshmërisë së saj) kërkon sërish që në të ardhmen ta përdorë atë me qëllim ushtrimin e profesionit, numri i krediteve të nevojshme për rilicencimin e tij për atë titull licence, të jetë më i ulët se 100 kredite, kjo në përpjesëtim të drejtë me periudhën kohore, në të cilën ka deklaruar mospërdorimin e asaj licence.

- Numri i krediteve që duhet të plotësojë psikologu në vazhdim, duhet të vendoset nga KEVP, pas paraqitjes së kërkesës.
- Përdorimi i licencës së pezulluar pa njoftimin e Urdhrit të Psikologut përben shkak për nisjen e gjykimit disiplinor.

5) Në lidhje me numrin e krediteve të nevojshëm për rilicencim, për këtë kategori psikologësh, të cilët duan t'i posedojnë të dyja licencat dhe ta ushtrojnë profesionin në të dyja fushat e kompetencës duhet që:

- Të zbatohen të gjitha parashikimet e Rregullores së Edukimit në Vazhdim. Këta psikologë do duhet që të përfitojnë 100 kredite përgjatë 5 viteve të vlefshmërisë për secilën nga licencat që disponojnë dhe që kanë interesin për t'i rinovuar.
- Duke u mbështetur në ndarjet që parashikohen nga Rregullorja e Edukimit në Vazhdim, sa i përket mënyrës se si duhen marrë kreditet, brenda dhe jashtë fushës së kompetencës, kjo kategori e psikologëve, të mund të shfrytëzojë mundësinë që kreditet e përfituara, nga marrja pjesë në një aktivitet të Edukimit në Vazhdim, të jenë të vlefshme për të përfitur kredite për rilicencim për të dyja (apo edhe më shumë) Licencat që ata disponojnë, duke u bazuar në parashikimet e kësaj rregullore, si psh:
 - a) Kreditet e përfituara nga një psikologu, i cili njëhën prej licencave e ka në fushën e kompetencës së Shëndetit Mendor, në një aktivitet të Edukimit në Vazhdim, që i përket fushës së shëndetit mendor, të vlejnjë si kredite të nevojshme për rilicencim në kategorinë e krediteve të përfituara brenda fushës së kompetencës dhe;
 - b) Kreditet e përfituara po nga i njëjti psikolog, nga pjesëmarrja në të njëjtin aktivitet, i cili ka edhe një tjetër fushë kompetence në ushtrimin e profesionit (psh fusha e Edukimit), të vlejnjë si kredite të nevojshme për rilicencim në kategorinë e krediteve të përfituara jashtë fushës së kompetencës.

Igli Çutra

Zyra Juridike

